



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 312/2 Prot.

Tiranë, më 26 / 4 /2018

V E N D I M

Nr. 111 , Datë 26 / 4 /2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 31, datë 28.02.2018, të paraqitur nga subjekti ankues V.R, kundër Bashkisë Berat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”¹. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se i është drejtuar disa herë Bashkisë Berat për të kërkuar leje për të ndërtuar një shtesë banjo por që nuk ka marrë përgjigje.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të ndihmohet për të marrë lejen e ndërtimit.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë

¹ V.R i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Beratit.

baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ankuesja nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionerit informacion të mjaftueshëm për të vijuar me shqyrtimin e ankesës, lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues nga ana e Bashkisë Berat. Duke qënë se në formularin e ankesës ishte lënë vetëm kontakti² i përfaqësuesit të komunitetit rom/egjiptian të qytetit të Beratit, shtetasit B.D, atëherë Komisioneri nëpërmjet telefonit i kërkoi³ atij informacione shtesë lidhur me shqyrtimin e ankesës. Gjithashtu, në datat 06.03.2018 dhe 13.04.2018, me anë të email-it u kontaktua sërish shtetasi B.D, por nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion rreth ankesës së shtetasës V.R.

Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 33, pika 4/ç të tij, parashikon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*.

Në këto kushte, pas analizimit të ankesës nr. 31, datë 28.02.2018, Komisioneri konstatoi se: Mungesa e shpjegimit se si mund të kontaktohet ankuesja dhe informacionit paraprak lidhur me sqarimin e situatës diskriminuese të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bën që nga ana formale dhe përmbajtja ankesa të jetë e pa plotësuar.

Përsa më lart, duke analizuar në tërësi ankesën nr. 31, datë 28.02.2018, të V.R, Komisioneri gjykon se, në rastin konkret ankesa bie ndesh me kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e në këto kushte në mungesë të informacionit të mjaftueshëm ajo nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të hetimit administrativ.

Pavarësisht mospërmbushjes së kriterëve ligjore të pranimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, që nëse kërkon që të pajiset me leje për shtesë ndërtimi, duhet të aplikojë nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve për tu pajisur me leje ndërtimi pranë njësisë së qeverisjes vendore, sipas nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

² Nr. i telefonit të përfaqësuesit të Komunitetit rom/egjiptian në qytetin e Beratit, shtetasit B. D.

³ Më datë 12.04.2018, i është kërkuar të vërë në dispozicion të KMD-së kontaktet e ankueses, si dhe kopje të kërkesës për leje ndërtimi ose datën e kërkesës nëse aplikimi është bërë online.

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 31, datë 28.02.2018, e V.R, pasi ankesa nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONERI